



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME
KORÇË

Nr. 4 .Prot

Korçë më 3/10/2023

Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele.

Drejtuar: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

Në zbatim të ligjit Nr.15 datë 2019 "Për nxitjen e punësimit", ligjit nr.15, datë 2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.554 datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive" Udhëzimit Nr.14 datë 27.05.2021 Neni 108 pika 7, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë të institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe aspekte të menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë të zhvillimit të ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit"

Njoftojmë për shpallje të lëvizjes paralele për pozicionet :

Mesimdhënes me kohe te plote

- Mësues i teorisë profesionale (Veterinari)

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të kultures profesionale në shkollën Profesionale Shërbime, Korçë.

1.1.Aplikanti duhet të plotësojë **kriteret e përgjithshme** për lëvizjen paralele si vijon :

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës të prerë për kryerjen e veprave penale .
- Te mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.
- Të demonstrojë vlera të larta të etikës.sjelljes dhe komunikimit.
- Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit .

1.2.Aplikanti duhet të plotësojë **kriteret e posaçme** për personelin mësimdhënës të kultures profesionale në shkollën Profesionale Shërbime, Korçë si vijon :

- të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga

kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;

b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2. Dokumentat e aplikimit

-Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë ;

-Letërmotivimin për pozicionin.

-Jetëshkrimin (CV), sipas modelit Europass Curriculum Vitae

-Kartën e identitetit.

-Diplomën.

-Librezën e punës.

-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në CV.

-Çertifikatë apo dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit.

-Vërtetim i gjendjes shëndetësore.

-Vërtetim i gjendjes gjyqësore .

-Vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka më masa disiplinore në fuqi.

-Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm .

3. Vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentave.

Aplikanti duhet të dorëzojë kërkesën për lëvizje paralele dhe dokumentacionin përkatës pranë shkollës Profesionale Shërbime, Korçë brenda 5 ditëve nga njoftimi. Afati i njoftimit fillon më datë 18.10.2023

Drejtoreshkollë

Tatiana MERO

